

Formular për SYLLABUS të lëndës

Të dhëna bazë për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti I Filologjisë: Dega e gjuhës dhe e letërsisë gjermane
Titulli i lëndës:	Përkthim gjermanisht-shqip
Niveli:	Bachelor
Statusi i lëndës:	Me zgjedhje
Viti i studimeve:	Viti II, semestri IV
Numri i orëve në javë:	1 + 2
Vlera në kredi - ECTS:	5
Koha dhe vendi:	L.: e premte : 12.00-14.00 /14.00-15.30, salla 51; 15.30-17.00, salla 53 U.: e enjte: 08.30-10:00, salla 39; 10.00-12.00, salla 51; 14.00-16.00, salla 39
Mësimdhënësi:	Prof. Ass. Dr. Naim Kryeziu
Detajet kontaktuese:	naimkryeziu@bluewin.ch
Përshkrimi i lëndës:	
	<p>Lënda e përkthimit nga gjermanisht në shqipja synon t'i njohë studentët me metodat, me vështirësitë dhe me mënyrat e përdorimit të mjeteve të ndryshme të përkthimit, siç janë fjalorët e ndryshëm e interneti, dhe me tekstet krahasuese. Gjatë zhvillimit të kësaj lënde do të përkthehen tekste të fushave të ndryshme nga gjermanishtja në shqip.</p> <p>Roli i përkthimit është tejet i rëndësishëm. Rëndësia e këtij roli është rritur krahas zhvillimit të shoqërisë dhe të kulturës njerëzore. Kësisoj, përkthimi është jo vetëm bashkudhëtar, por edhe interpretues i letërsisë dhe i veprës letrare në shoqëri. Vetëm falë një përkthimi të mirëfilltë e me vlerë, një kryevepër e një artisti të madh të fjalës bëhet me të vërtetë vepër e letërsisë së përbotshme dhe kalon ngadhënjimtarisht kufijtë e vendeve e të shekujve, qarkullon në hapësirë e në kohë dhe ndikon sidomos në rrafshin e jetës shoqërore, kulturore, estetike, artistike dhe etike të njerëzimit.</p>
Qëllimet e lëndës:	<ul style="list-style-type: none"> • T'i njohë studentët: • me teorinë, me metodologjitë dhe me

	<p>strategjitë e përkthimit</p> <ul style="list-style-type: none"> • me burimet e informacioneve që mund t'i shërbejnë gjatë procesit të përkthimit • me praktikat profesionale të përkthimit nga gjuha gjermane në gjuhën shqipe dhe anasjelltas.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<p>Pas mbarimit të kësaj lënde studenti duhet të ketë përvetësuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> • metodat kryesore të përkthimit në përgjithësi • objektin kryesor të teorisë së përkthimit • dallimin midis përkthimit të teksteve letrare dhe të teksteve të tjera • njohuritë themelore të praktikës së përkthimit • rëndësinë e përdorimit të frazeologjisë, të sinonimisë dhe të antonimisë të gjuhës në të cilën përkthen.

Kontributi në ngarkesën e studentit (kjo duhet të përkojë me rezultatet e përvetësimit nga ana e studentit)

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	1	15	11.25
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	22.5
Kontaktet me mësimdhënësin	10 min.	15	2.5
Kollokfiume, seminare	5	2	10
Detyra të shtëpisë	2	15	30
Koha e studimit vetanë të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgatitja përfundimtare për provim	10	2	20
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	1	2	2
Projektet, Prezantimet ,etj	30 min.	1	0.5
Totali			129 :25 = 5.16 5 ECTS

Metodologjia e mësimdhënies:	<p>Mësimi zhvillohet me ligjërata dhe me ushtrime. Gjatë ushtrimeve zbatohet metoda ndërvepruese.</p> <p>Ushtrimet bëhen sipas temave dhe detyrave</p>
------------------------------	--

	të caktuara. Ushtrimet zhvillohen në grupe e në çifte, por edhe në mënyrë individuale. Studentët janë të detyruar të bëjnë punime seminari dhe të përkthejnë tekste nga fusha të ndryshme.
Metodat e vlerësimit:	<ul style="list-style-type: none"> • Detyrat e shtëpisë 20 % • Angazhimi gjatë orës 5 % • Vijimi i rregullt në mësim 5 % • Provimi përfundimtar (me shkrim/me gojë) 70%
Literatura	
Literatura bazë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Verlag: ;Gunter Narr Verlag, 2011 "Übersetzungstheorien: Eine Einführung" Autor: Radegundis Stolze ISBN-13: 978-3823366799 2. Verlag: Utb, 2011 "Einführung in die Übersetzungswissenschaft" Autor: Werner Koller ISBN-13: 978-3825235208 3. Verlag: Gunter Narr Verlag, 2009 "Verstehen und Übersetzen. Ein Lehr- und Arbeitsbuch" Autor: Paul Kussmaul ISBN-13: 978-3823365426
Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Übersetzungswissenschaft / Eine Neuorientierung.</i> 2. Auflage, Autor: Mary Snell-Hornby, UTB für Wissenschaft Francke Verlag Tübingen und Basel, ISBN 3-8252- 1415-X, 1994 Tübingen
Plani i detajuar i mësimit	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
<i>Java e parë</i>	Hyrje në shkencat e përkthimit, përkthimi, gjuha, kultura
<i>Java e dytë</i>	Rëndësia kulturore dhe letrare e përkthimit
<i>Java e tretë</i>	Përkthimet letrare
<i>Java e katërt</i>	Përkthimet e teksteve gazetareske
<i>Java e pestë</i>	Relativiteti i përkthimeve
<i>Java e gjashtë</i>	Kuptimi i teksteve, përkthimi i teksteve dhe kritika e përkthimeve

<i>Java e shtatë</i>	Rëndësia e interpretimit gjuhësor të tekstit gjatë përkthimit
<i>Java e tetë</i>	Qartësia në tekstet e fushës përkatëse shkencore
<i>Java e nëntë</i>	Krahasimi i terminologjisë dhe përshtatja e terminologjisë ndërkombëtare
<i>Java e dhjetë</i>	Përkthimet në procesin e komunikacionit - Përkthimet industriale
<i>Java e njëmbëdhjetë</i>	Përkthimet në fushën e ekonomisë
<i>Java e dymbëdhjetë</i>	Përkthyesi dhe formulimi i teksteve
<i>Java e trembëdhjetë</i>	Didaktika e përkthimit
<i>Java e katërbëdhjetë</i>	Analiza e gabimeve në tekstet e përkthyer
<i>Java e pesëmbëdhjetë</i>	Mundësitë e përkthyesve për shkollim - shkollimi akademik i përkthyesve.

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes

Studentët duhet të vijnë me kohë në auditor, sepse ardhja me vonësë sjell ndërprerjen e mësimit dhe pengon, çrregullon e shpërqendron vëmendjen e studentëve. Gjatë orës së mësimit nuk lejohet përdorimi i mjeteve elektronike, sepse shkaktojnë zhurmë ose pengesa të tjera.

Hartoi: Prof. Ass. Dr. Naim Kryeziu

Mars, 2014